



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar-mars 2020", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 14. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 15. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 18. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar-mars 2020", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjen e datës 30.01.2020. Siç jeni vënë në dijeni nga njoftimet, në rend të ditës sot janë 6 çështje për diskutim.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar-mars 2020", i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

(Prezantimi i pikave të rendit të ditës nuk është mundur të regjistrohet për shkak të një defekti teknik në audio. Regjistrimi fillon me trajtimin e pikës së parë të rendit të ditës, me fjalën e zotit Erjon Muharremaj.)

Atëherë, kalojmë në relatimin e projekt-aktit të parë.

Fjalën ia jap zotit Erjon Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, për sa i përket formimit fillestar dhe formimit vazhdues që kjo Shkollë organizon, me qëllim rritjen profesionale të gjyqtarëve. Në këtë kuadër Shkolla e Magjistraturës ka koordinuar dhe ndjekur metoda sistematike dhe të përshtatshme për vlerësimin e nevojave për trajnim të magjistratëve. Mendimi në lidhje me përmbajtjen tematike të Programit të Formimit Vazhdues, i është kërkuar paraprakisht edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe çdo gjyqtari. Pas këtij procesi konsultimi, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar në datën 02.07.2019 "Programin e Formimit Vazhdues", për vitin akademik 2019-2020, i cili u është dërguar të gjitha gjykatave, me qëllim që gjyqtarët të aplikojnë në përmbushje të detyrimit ligjor për ndjekjen e trajnimit

vazhdues, në përputhje me nenin 5 të ligjit për Statusin. Bashkë me programin e trajnimit, gjyqtarëve u është vënë në dispozicion në rrugë elektronike, formulari i aplikimit për pjesëmarrje me tre rubrika: Rubrika e parë “Tema prioritare”, rubrika e dytë “Tema niveli 2” dhe rubrika e tretë “Tema niveli 3”. Formularët janë plotësuar nga ana e gjyqtarëve dhe i janë dërguar Shkollës së Magjistraturës nga ana e Kryetarëve të Gjykatave. Në vijim të procedurës, kalendari i aktiviteteve trajnuese është miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues të shkollës në datën 03.10.2019. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar pjesëmarrjen për 3-mujorin e parë të vitit akademik, që përfshin periudhën tetor-dhjetor 2019, me vendimin nr. 246, të datës 04.11.2019.

Në vijim të programit vjetor të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr.41 prot., datë 14.01.2020, ka dërguar pranë KLGJ listën e aktiviteteve trajnuese të programit të trajnimit vazhdues dhe atë të gjyqtarëve që kanë aplikuar për të marrë pjesë në këtë program, për tre-mujorin e dytë të vitit akademik 2019-2020, që përkon me tremujorin e parë të vitit kalendarik 2020 (janar-mars), me qëllim miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve aplikues.

Në bazë të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pjesëmarrja e gjyqtarëve në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Konkretisht:

Në nenin 272, pika 1 dhe 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes”, parashikohet se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen formimit vazhdues sipas rregullave të parashikuara në ligjin për Statusin. ... 3. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, miratojnë pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin vazhdues, sipas programit të përcaktuar të formimit vazhdues dhe ia dërgojnë Shkollës së Magjistraturës në fillim të vitit akademik”.

Ndërsa në nenin 88, shkronja “a” dhe “c” të ligjit për Qeverisjen, parashikohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe kryen detyrat e mëposhtme: (ndër të tjera) ...mban lidhje me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve... si

dhe, vendos mbi kërkesat e gjyqtarëve për trajnimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”.

Në referim të parashikimeve ligjore të mësipërme, lista e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese të magjistratëve (të cilët mund të jenë gjyqtarë në detyrë apo të komanduar në funksione të tjera), miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i dërgohet Shkollës së Magjistraturës. Nga rregulli i përgjithshëm bëjnë përjashtim rastet e parashikuara nga neni 271 pika 4 e ligjit për Qeverisjen, në të cilin parashikohet mundësia e përditësimit të programit tematik dhe listës së pjesëmarrësve nga Shkolla e Magjistraturës, e cila njofton Këshillin për ndryshimet përkatëse në programin e trajnimit vazhdues të miratuar në fillim të vitit akademik.

Në lidhje me pjesëmarrjen në aktivitetet e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në nenin 5 të ligjit për Statusin, parashikohet detyrimi ligjor i magjistratëve për të ndjekur programin e formimit vazhdues në përputhje me parashikimet e këtij neni (pikat 1, 2, shkronja “a”); detyrimi për të respektuar kufijtë e angazhimit në programin e trajtimit vazhdues, përkatësisht, jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më shumë se 40 ditë të plota në vit, si dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë viteve; mundësia e pjesëmarrjes në formimin vazhdues në programin e trajnimit të organizuar jo vetëm nga Shkolla e Magjistraturës por edhe institucione të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të njohura nga KLGJ-ja, me kushtin që aktivitetet trajnuese të vlerësohen të përshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit.

Në nenin 5 pika 6 të ligjit për Statusin, parashikohet se: Këshilli, ndër të tjera, bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës edhe për përcaktimin e procedurës së pajisjes me leje për ndjekjen e aktiviteteve trajnuese.

Referuar sa më lart, në pikën e parë të projektvendimit që i paraqitet sot Këshillit është përcaktuar miratimi i listës së gjyqtarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e përcaktuara, sipas kërkesave të përcjella prej tyre pranë Shkollës së Magjistraturës. Nga shqyrtimi i listës së pjesëmarrësve konstatohet se kërkuesit ushtrojnë detyrën e gjyqtarit ose gjyqtarit të komanduar në KLGJ, të cilët plotësojnë kushtet ligjore dhe kanë

detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në referim të nenit 5 të ligjit për Statusin. Për këtë shkak, kërkesa e tyre për të marrë pjesë në aktivitetet përkatëse sipas listës që i bashkëlidhet vendimit, është e mbështetur në nenet 1 dhe 5 të ligjit për Statusin.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar që në listën e miratuar, të mos përfshihen gjyqtarët të cilëve u ka mbaruar statusi i magjistratit në referim të nenit 1 pika 2 dhe 64 të ligjit për Statusin. Kështu që, këta gjyqtarë nuk janë pjesë e kësaj listës që i bashkëlidhet vendimit.

Në referim të parashikimeve të nenit 65 të ligjit për Statusin, miratimi i dorëheqjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor passjell mbarimin e statusit të magjistratit dhe për pasojë, përfundimin e të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me statusin e magjistratit në kuptim të nenit 1, pika 2 dhe nenit 5 të ligjit për Statusin.

Për këto arsye gjyqtarët e përjashtuar nuk mund të jenë pjesë e listës së miratuar për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Nga listat e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës konstatohet se disa gjyqtarë janë në listat përkatëse për dy seminare me tema të ndryshme në të njëjtën ditë. Kështu që, për shkak të mbivendosjes së datave, duke qenë që gjyqtarët nuk kanë qenë në dijeni për datat e zhvillimit të aktiviteteve në momentin që kanë aplikuar, por kanë ditur vetëm temat, është vlerësuar që gjyqtarët përkatës të zgjedhin aktivitetin në të cilin do të marrin pjesë sipas temës së kërkuar.

Në pikën e dytë të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i magjistratëve për të marrë pjesë në sesionet e aktivitetit trajnues sipas rregullave të përcaktuara nga organizatori i aktivitetit, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së tyre, zhvillimin e rregullt të aktivitetit trajnues si dhe certifikimin e pjesëmarrësit, si një ndër elementët e vlerësimit profesional të tij, pasi certifikata e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese përfshihet në dosjen personale të magjistratit dhe është pjesë e elementëve të vlerësimit të tij profesional, në referim të nenit 5, pika 4, shkronja “b” dhe nenit 77, shkronja “a” dhe “c” (*lapsus shkronja “c”, është pika “e”*) të ligjit për Statusin. Rregullat e hollësishme për

pjesëmarrjen dhe certifikimin e gjyqtarit janë përcaktuar në Rregulloren e Shkollës së Magjistraturës.

Në pikën e tretë të projektvendimit të paraqitur përpara jush është përcaktuar detyrimi i magjistratit për të organizuar paraprakisht punën lidhur me planifikimin e seancave dhe veprimeve që kanë lidhje me gjykimin e çështjeve, me qëllim që të mos shtyhen seancat gjyqësore për shkak të pjesëmarrjes në aktivitetet trajnuese. Për efekt të organizimit të punës brenda gjykatës ku magjistrati ushtron funksionin e tij, një kopje e vendimit me miratimin e listës së pjesëmarrësve në aktivitetet trajnuese i njoftohet të gjitha gjykatave në të cilat ushtrojnë funksionin gjyqtarët, sipas listës së miratuar.

Në pikën e katërt të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i njoftimit të vendimit Shkollës së Magjistraturës dhe gjykatave apo institucioneve ku gjyqtarët pjesëmarrës ushtrojnë detyrën e gjyqtarit apo detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Në vlerësim të Komisionit, detyrimi i gjyqtarit për të respektuar kufijtë ligjorë minimalë dhe maksimalë të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese në referim të parashikimeve të nenit 5 pika 3 të ligjit për Statusin, me qëllim që të garantohet trajnimi i përshtatshëm në nivel sasior dhe cilësor të magjistratit, buron nga ligji dhe nuk mund të jetë pjesë e vendimmarrjes së Këshillit (të Mbledhjes Plenare). Gjithsesi, referuar listës së pjesëmarrësve dhe periudhës 3-mujore, është propozuar miratimi i një pjesëmarrjeje brenda kufijve të detyrimit ligjor, jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 40 ditë në vit.

Në lidhje me këtë kompetencë të Mbledhjes Plenare, referuar nenit 61 të ligjit për Statusin (*lapsus ligji për Statusin, është ligji 115/2016*) Komisioni vlerëson se, ky vendim për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në thelb nënkupton pajisjen e gjyqtarëve me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve, sipas pikës 6 të nenit 5 të ligjit për Statusin. Pavarësisht se çështjet që lidhen me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve nuk janë kompetencë e Mbledhjes Plenare, për sa kohë nuk ka ende nuk kemi marrë vendimin si Këshill në lidhje me procedurën e pajisjes me leje për ndjekjen e trajnimeve vazhduese (i cili në vetvete është një akt nënligjor normativ) dhe për sa kohë që nuk kemi miratuar një rregullore të brendshme për të cilat

çdo Komision i Përhershëm ka kompetenca vendimmarrëse, Komisioni ynë vlerësoi që këtë çështje ta paraqesë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Duke menduar që ky është një akt administrativ kolektiv, ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në referim të parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes”. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të miratojë kërkesat e gjyqtarëve për të marrë pjesë në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën janar-mars 2020, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Gjyqtarët e miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit trajnues.

Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët pjesëmarrës në trajnim ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Udhëzues për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 14. Gentiana Bigu , Këshilltare e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 15. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 18. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Udhëzues për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projekt-aktit, pra udhëzimit për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Për relatimin e këtij projekt-akti, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, udhëzimi është shumë i detajuar dhe i është vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve para mbledhjes, kështu që unë nuk do ndalem në përmbajtjen e udhëzimit por do shpjegoj shkurtimisht arsyet për të cilat na kanë detyruar që të nxjerrim këtë udhëzim, i cili në vetvete nuk është gjë tjetër veçse një pasqyrim më analitik i relacionit që Komisioni ka përdorur në momentin kur i ka prezantuar mbledhjes plenare vendimmarrjen për miratimin e formatit të tabelave standarde për të dhënat statistikore.

Në kuadër të plotësimit të skemës së vlerësimit, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill, i ka propozuar mbledhjes plenare dhe Këshilli ka miratuar rregullat plotësuese, metodologjinë dhe tabelat standarde me të dhënat statistikore. Pas miratimit të tabelave standarde, ato janë hartuar në format elektronik dhe atë shkresor dhe i janë përcjellë të gjitha gjykatave, gjyqtarët e të cilave ishin pjesë e programit vjetor të vlerësimeve për vitin 2020. Me marrjen e këtyre tabelave statistikore, nga shumica e kancelarëve të gjykatave janë drejtuar shumë pyetje lidhur me mënyrën se si do të plotësoheshin këto tabela statistikore. Për këtë qëllim, me ndihmën e projektit USAID është realizuar një tryezë e rrumbullakët, me të gjithë kancelarët e gjykatave, për të prezantuar problematikat që kishin dhe për të diskutuar edhe lidhur me vendimmarrjet dhe zgjidhjet që kishte dhënë Këshilli.

Nga të gjithë kancelarët u kuptua që kishte mendime të ndryshme për mënyrën se si do të plotësoheshin tabelat statistikore, çka mund të sillte në një pasqyrim jo të qartë

dhe jo të uniformizuar të të dhënave statistikore nga të gjitha gjykatat, lidhur me gjyqtarët e tyre. Për këtë arsye edhe në fund të takimit, por edhe si Komision, vlerësuam që duhet të nxjerrim një udhëzues lidhur me mënyrën se si duhet të plotësohen tabelat statistikore nga të gjithë nëpunësit gjyqësorë civilë në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit.

Sipas nenit 94 në fakt të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar që të nxjerrë udhëzues për mbajtjen e statistikave gjyqësore (është neni 94 i këtij ligji në kuadër të rregullave të eficiencës për sa i përket performancës së gjykatave).

Udhëzuesi i tabelave statistikore konsiston në dy drejtime: duhet të ketë udhëzues të tabelave statistikore për sa i përket performancës së gjyqtarit dhe për sa i përket performancës së gjykatave.

Për sa i përket performancës së gjyqtarit, pikërisht, ky udhëzues që ne i kemi propozuar sot për miratim mbledhjes plenare, është ezaurues, lidhur me çdo indikator dhe çdo emërtim të posaçëm në tabela të veçanta dhe në tabela përmbledhëse që duhet të plotësohen nga kancelarët apo edhe nëpunës të tjerë gjyqësorë, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Udhëzuesi është i konceptuar në tre kapituj: për gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, është një kapitull; për gjykatën administrative të shkallës së parë dhe gjykatën administrative të apelit është kapitulli i dytë; për gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit për krimet e rënda, sot gjykata e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, është një kapitull i tretë.

Jemi ndalur me imtësi në përmbajtje të tabelave, në llojet dhe kategoritë e çështjeve se çfarë do të përfshihen në këto çështje, pra cilat janë çështjet me palë kundërshtare, cilat janë çështjet familjare, cilat janë çështjet civile të përgjithshme, duke sjellë shembuj dhe duke iu bërë të ditur gjykatave që lista e propozuar nuk është shteruese, por mund të jetë edhe më e gjerë.

Gjithsesi, janë vendosur kriteret për mënyrën se si do të përfshihen çështjet në kategori të ndryshme të tyre.

Është përcaktuar në udhëzues edhe mënyra se si do të plotësohet çdo indikator dhe çdo emërtim që ka të bëjë me numrin e aktit që ka të bëjë me datën e regjistrimit; datën e shortit; datën e nxjerrjes për gjykim në gjykatat e apelit; si plotësohet rubrika e relatorit, e anëtarit; si plotësohet afati i përfundimit të gjykimit; si llogaritet afati i standardit minimal; si llogaritet dhe si plotësohet tabela në rastet kur gjyqtari është në tejkalim të këtyre afateve apo brenda këtyre afateve; të gjitha janë të përmendura në udhëzues.

Unë nuk do doja të ndalesha edhe një herë sepse relativ të gjatë të përmbajtjes së udhëzuesit e kemi bërë në momentin kur kemi prezantuar tabelat me të dhënat statistikore. Faleminderit, zonja Kryetare!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë sugjerim apo diskutim lidhur me përmbajtjen e udhëzuesit?

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e Udhëzuesit “Për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj vendimit nr. 262 datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 14. Gentiana Bigu , Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 15. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 18. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj vendimit nr. 262 datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj vendimit nr. 262 datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit”. Projekt-akt i cili do relatohet nga zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 12.11.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, të kandidatit z. {...}”, pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin e këtij kandidati dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar, me vendimin nr. 253, datë 12.11.2019 ka vendosur skualifikimin e kandidatit z. {...}, i diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar.

Kandidati {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mësipërm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku kjo e fundit me vendimin nr. 262, datë 23.12.2019 ka vendosur:

1. Pranimin e padisë së paditësit {...}.

2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 253, datë 12.11.2019 “Për skualifikimin e kandidatit z. {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar”.

Në pikën 3 gjykata ka vendosur kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...} dhe detyrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vijuar procedurën e emërimit si gjyqtar të paditësit {...}.

Në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në vijim të kësaj procedure, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur me vendimin nr. 15, datë 09.01.2020 të emërojë gjyqtar z. {...}.

Me datë 15.01.2019 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar vendimi nr. 262, vendimi i arsyetuar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me nr. 262, datë 23.12.2019.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj vendimit nr. 262, datë 23.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë që i përket paditësit {...}”, duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, të miratojë projektvendimin për ushtrimin e së drejtës së rekursit ndaj vendimit nr. 262, datë 23.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Jo!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të ushtrojë të drejtën e rekursit ndaj vendimit gjyqësor nr. 262, datë 23.12.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë që i përket palës paditëse {...}.

Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike për të vijuar më tej procedurën e rekursit dhe depozitimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 14. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 15. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 18. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës, e cila ka të bëjë me ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për verifikimin dhe plotësimin e kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Fjalën për relatimin e këtij projekt-akti ia kaloj zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, me vendimin nr. 31, datë 23.01.2020, “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, përcaktoi edhe numrin e kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, konkretisht 25 (njëzet e pesë).

Miratimi i këtij vendimi i hap rrugën procesit të aplikimit dhe, më tej, të regjistrimit për konkurrim në Shkollën e Magjistraturës, edhe të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Sipas ligjit, në përfundim të këtij procesi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin për verifikimin e kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, përcaktuar kjo në nenin 53, pikat 4/b dhe 9, të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, titulluar “Vlerësimi kualifikues për kancelar, këshilltar dhe ndihmës ligjor”, sipas të cilit: “... 4. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka për detyrë: ...; b) të përcaktojë listën e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e pranimit.

... 9. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të hollësishme për mënyrën e përlogaritjes së numrit të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar dhe verifikimin e kandidatëve që pranohen në provimin e pranimit”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”.

Sipas këtij projektvendimit, Komisioni i Përkohshëm do të verifikojë plotësimin e kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, duke i propozuar për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda datës 10 mars 2020, listën përkatëse të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret.

Krijimi i këtij Komisioni është në mbështetje të nenit 62, pika 14, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta”. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm, sipas projektvendimit, propozohet të jetë tre anëtarë, dy anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar, të cilët Këshilli, me propozim të Kryetarit apo çdo anëtari, që zgjidhen me propozim të Kryetarit apo çdo anëtari, ndërkohë që Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit.

Sipas projektvendimit, Komisioni i Përkohshëm do të koordinojë punën dhe do të bashkëpunojë me Shkollën e Magjistraturës, në mënyrë që Këshilli, jo më vonë se data 15 mars 2020, të shqyrtojë propozimin e Komisionit të Përkohshëm.

Ky ishte relacioni për projektvendimin. Ne jemi në fakt në miratim e sipër të rregullores që përfshin edhe këtë çështje, por ajo çështje u shty dhe do duhet të reflektojmë ende disa sugjerime që bëhen nga kolegët gjatë mbledhjes së kaluar, kështu që nuk kemi asnjë pengesë që të ngremë menjëherë Komisionin, sa kohë ka filluar, janë

shpallur njoftimet për fillimin e procesit të aplikimit dhe të regjistrimit. Kështu që do të ngrihet një Komision që t'i përballë kësaj situatë që kemi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Jo!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, dy anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.

Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të bërë nga Kryetari apo çdo anëtar i Këshillit, ndërsa Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e tij me propozim të Kryetarit të Këshillit.

Komisioni i Përkohshëm verifikon plotësimin e kriterëve ligjorë të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, duke i propozuar për miratim Këshillit të

Lartë Gjyqësor, brenda datës 10 mars 2020, listën përkatëse të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret.

Për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, Komisioni i Përkohshëm, në koordinim dhe bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, administron dhe shqyrton dokumentacionin e depozituar nga çdo kandidat.

Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrton propozimin e Komisionit të Përkohshëm jo më vonë se data 15 mars 2020.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në Vendimin nr. 30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.**
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.**
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.**
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 14. Gentiana Bigu , Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 15. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 16. Gregor Borkowski, EURALIUS.**
- 17. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 18. Valbona Bala, USAID.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në Vendimin nr. 30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Pra, kalojmë tek çështja e radhës e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në Vendimin nr. 30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Fjalën ia jap zotit Ilir Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes shkurtimisht relacionin shpjegues për projektvendimin “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në Vendimin nr. 30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr.30, të vitit 2019, të Këshillit, me Vendimin e tij nr. 30, datë 21 janar 2020, sipas nevojave të gjykatave të ndryshme, ka bërë caktimin e disa gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Në paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, pika 5, të Vendimit nr. 30, datë 21.01.2020, mbi kërkesën e Gjykatës së Apelit Vlorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur që gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Nure Dreni (relatore), Sokol Binaj dhe Albana Boksi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Kallëzues: {...}, {...}; Objekti: “Pushim i akuzës dhe çështjes penale...” numri dhe data përkatëse.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Gjykata e Apelit Vlorë, përmes e-mail-it të datës 29 janar 2020, ka parashtruar kërkesën për korrigjimin e vendimit si më lart të Këshillit, pikërisht të paragrafit I, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, pika 5, kjo sa i përkiste emrit të të pandehurit nga “{...}” në “{...}”. Sipas gjykatës, gabimi në emrin e të pandehurit ka ardhur për shkak të pasaktësisë së emrit të shënuar prej në kërkesën fillestare për caktim gjyqtari.

Nisur nga sa rezulton, është vendi për korrigjimin e gabimit në shkrim të bërë në Vendimin nr. 30, datë 21 janar 2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 1, të nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative, por edhe pikës 3 të nenit 97 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe projektvendimin “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në Vendimin nr. 30, datë 21 janar 2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, sipas të cilit, në pikën 1, përcaktohet korrigjimi i gabimit në shkrim në paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, pika 5, të Vendimit nr.30, datë 21 janar 2020, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

“5. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Nure Dreni (relatore), Sokol Binaj dhe Albana Boksi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Kallëzues: {...}, {...}; Objekti: “Pushim i akuzës dhe çështjes penale nr.957/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet njoftimi i vendimit për tre gjyqtarët e caktuar për çështjen konkrete, si dhe Gjykatën e Apelit Vlorë.

Së fundi, në projektvendim është përcaktuar hyrja menjëherë në fuqi e vendimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ken i ndonjë sugjerim apo paqartësi lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Korrigjimin e gabimit në shkrim në paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, pika 5, të Vendimit nr. 30, datë 21.01.2020, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, si më poshtë:

“5. Gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Nure Dreni (relatore), Sokol Binaj dhe Albana Boksi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Kallëzues: {...}, {...}; Objekti: “Pushim i akuzës dhe çështjes penale nr.957/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

Një kopje e vendimit t’i njoftohet Nure Dreni, Sokol Binaj dhe Albana Boksi, si dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 30.01.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:33 dhe mbaroi në orën 10:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve.*
- 9. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 10. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 11. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Vjollca Kola, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 13. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 14. Gentiana Bigu , Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

RENDI I DITËS:

6. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Naureda Llagami: Kalojmë te çështja e radhës e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Fjalën ia kaloj për relativimin e këtij projekt-akti zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, nga gjykatat e apelit dhe të shkallës së parë janë paraqitur disa kërkesa për caktim gjyqtari në çështje gjyqësore të veçanta. Fillimisht duhej bërë prezent fakti se për disa gjykata, kërkesat konsistojnë në caktimin e gjyqtarit, ndërsa ne ditën e djeshme emëruam disa gjyqtarë, që gjatë relativimit do t'ju bëhet prezent ky fakt. Duhet që Këshilli të marrë vendim për të deklaruar të përfunduar procesin e shqyrtimit të këtyre kërkesave, sa kohë mbeten pa objekt. Ndërsa në disa raste të tjera, nëse është konsideruar kërkesa për dy apo tre gjyqtarë, për vetë faktin e caktimit të një gjyqtari në ato gjykata, do duhet të konsiderojmë të caktojmë më pak gjyqtarë për çështjet konkrete.

Atëherë, fillimisht ju propozoj radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave. Fillimisht, gjykata e apelit që është vetëm Gjykata e Apelit Korçë. Pastaj gjykatat e shkallës së parë, që janë gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksionit, gjykatat me juridiksion të përgjithshëm: gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe më pas Mat.

Gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: që është vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet. Ndërkohë që për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë do duhet të marrim vendim për deklarimin e përfundimit të procedurave të shqyrtimit.

Më pas gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Më pas gjykata e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Dhe në fund janë gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: që fillimisht është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, më pas Lezhë dhe në fund Kukës, për të cilën do duhet të deklarojmë përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të bërë nga kjo gjykatë.

Në fund janë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ. Fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe më pas ajo Gjirokastrë, për të cilat në dy raste do duhet të deklarojmë përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të paraqitura në këto dy të fundit.

Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ilir Toska: Faleminderit!

Vazhdojmë atëherë me **Gjykatën e Apelit Korçë**, sa kohë Këshilli është dakord me propozimet.

Duhet t'ju bëj të ditur që sipas vendimit që morëm lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktim gjyqtari, për sa i përket Gjykatës së Apelit Korçë, janë përfshirë vetëm 4 çështje. Ndërkohë janë 13 çështje të tjera që janë vetëm kërkesa për përjashtim gjyqtari, të cilat kanë ardhur gjatë kësaj kohe. Por për t'i dhënë rrugë vijimit të atyre proceseve, nëse nuk e dimë nëse kanë të bëjnë me të paraburgosur, pra ato kriteret specifike që vumë për Gjykatën e Apelit Korçë, duhet të procedojmë me caktimin e gjyqtarëve për shqyrtimin e këtyre kërkesave për përjashtim, që janë edhe në lëndë penale edhe në lëndë civile, krahas katër kërkesave që përfshihen në kriteret e përcaktuara për Gjykatën e Apelit Korçë, për të cilën Këshilli do të operojë më shpejt nga një mënyrë periodike më e gjatë se do duhet të konsiderojmë në të ardhmen.

Vazhdojmë atëherë me shortin elektronik.

Fillimisht do t'ju them propozimet konkrete.

Gjykata e Apelit Korçë - janë në lëndë penale 11 çështje, nga të cilat 3 kanë të bëjnë me themelin dhe 8 janë kërkesa për përjashtim, ndërkohë që ka 5 çështje në lëndë civile (vetëm njëra për themelin dhe të tjerat, katër kërkesa janë përjashtim gjyqtari).

Në këto kërkesa, në dy raste objekti i tyre ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit Stavri Kallço. Ndërkohë këto kërkesa janë bërë përpara se për gjyqtarin Stavri Kallço Këshilli të vendoste deklarinimin e mbarimit të statusit me vendimin e datës 9 janar 2020. Çështjet konkrete sipas numrave rendor janë nr. 4 dhe nr. 9. Për rrjedhojë, të dy këto kërkesa kanë mbetur pa objekt, çka bën inekzistente nevojën e Gjykatës së Apelit Korçë për caktim gjyqtari në këto raste.

Në këto kushte, për kërkesat me nr. 4 dhe nr. 9 si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë është vendi që Këshilli të vendosë për deklarinimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 e tij. Në këto kushte, propozimi për këto dy kërkesa i Komisionit është si më poshtë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktim gjyqtari: për kërkesën nr.1564 prot.,, datë 11.12.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë; kërkesës nr.1565 prot.,, datë 13.12.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Jeni dakord me këtë propozim? Se ky nuk i nënshtrohet shortit.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Okej!

Atëherë, për kërkesat e tjera, nevojat e Gjykatës së Apelit Korçë për kërkesat e tjera, me përjashtim të kërkesave nr. 4 dhe nr. 9, nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit, për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 15 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Apelit Shkodër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 15 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë

6 gjyqtarë, nga të cilët 3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 3 nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Propozimet vijuese të Komisionit janë, për çështjen nr. 6 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja Vojsava Osmanaj e Gjykatës së Apelit Shkodër, e caktuar më herët për shqyrtimin e një kërkesë tjetër të së njëjtës natyrë, në po të njëjtën çështje penale, sipas informacionit të dhënë nga Gjykata e Apelit Korçë.

Për çështjet nr.1, nr.2, nr.3, nr.10, nr.11, nr.14 dhe nr.15, për të cilat kërkohet caktimi i 1, 2 dhe 3 gjyqtarëve, të caktohen 3 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Për çështjet nr.5, nr.7, nr.8, nr.12, nr.13, nr.16 dhe nr.17, për të cilat kërkohet caktimi i 1 dhe 3 gjyqtarëve, të caktohen 3 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka këto propozime: Përjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht znj. Iliba Bezati dhe z. Astrit Kalaja.

Po kështu, të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarët e apelit Vlorë të cilët janë caktuar me shortin e datës 21 janar 2020 në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, pra në shortin e javës së kaluar, që janë gjyqtarët Sokol Ngresi dhe Petrit Aliaj.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit sipas propozimeve të bëra nga Komisioni.

Valbona Bako: Atëherë, sipas propozimit të parë, për çështjen nr. 6, e përzgjedhur është gjyqtare Vojsava Osmanaj.

Ndërsa, sipas propozimit të dytë, për çështjen nr. 11 kemi gjyqtarë të përzgjedhur Skënder Damini (relator) dhe anëtarë Hysen Saliko dhe Klodiana Gjyzari.

Për çështjen nr. 2 në tabelë, gjyqtari i përzgjedhur është Skënder Damini.

Për çështjen nr. 3, gjyqtar Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 14 në tabelë, gjyqtarët e përzgjedhur janë Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini.

Për çështjen nr. 1, gjyqtari i përzgjedhur Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 15, gjyqtarët e përzgjedhur janë Klodiana Gjyzari (relatore) dhe anëtarë Skënder Damini dhe Hysen Saliko.

Dhe për çështjen nr. 10 gjyqtari i përzgjedhur është Hysen Saliko (relator) dhe anëtarë Klodiana Gjyzari dhe Skënder Damini.

Sipas propozimit nr. 3 kemi për çështjen nr. 10 të përzgjedhur gjyqtarët Lindita Hoxha (relatore), Selim Kryeziu dhe Aleks Nikolli (anëtarë). Po! Për çështjen nr. 12 në tabelë. Gjyqtarët janë Lindita Hoxha (relatore), dhe anëtarë Selim Kryeziu dhe Aleks Nikolli.

Për çështjen nr. 8, gjyqtare Lindita Hoxha.

Për çështjen nr. 5, gjyqtar Selim Kryeziu.

Për çështjen nr. 13, gjyqtar Aleks Nikolli (relator) dhe anëtarë Lindita Hoxha dhe Selim Kryeziu.

Për çështjen nr. 16, gjyqtarët Selim Kryeziu (relator) dhe anëtarë Aleks Nikolli dhe Lindita Hoxha.

Për çështjen nr. 7, gjyqtar Aleks Nikolli.

Dhe për çështjen nr. 17, gjyqtarët Lindita Hoxha (relatore) dhe anëtarë Selim Kryeziu dhe Aleks Nikolli.

Ilir Toska: Mbarojnë procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka paraqitur nevojë në 6 çështje, që janë në lëndë penale. Kërkesat janë paraqitur përpara caktimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të një gjyqtari ditën e djeshme, të znj. Elisabeta Gjoni.

Në këto kushte, për kërkesat me nr. rendor 1, 2, 3 dhe 4, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, aktualisht nuk ekziston më nevoja në Gjykatën e Rrethit Krujë, shkak për të cilin,

bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 97/3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni propozon që Këshilli të vendosë deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të këtyre kërkesave me referencat konkrete: kërkesën nr. 323 prot., datë 17.12.2019, kërkesën me nr. 18/137 prot., datë 14.01.2020, kërkesa me nr. 79 prot., datë 14.01.2020 dhe kërkesa me nr. 63/337 prot., datë 20.01.2020.

Sa i përket çështjeve 5 dhe 6 të cilat nevoja është 2 dhe 3 gjyqtarë, me caktimin e gjyqtarës Elisabeta Gjoni, nevojat në këto çështje bëhen për 1 dhe 2 gjyqtarë dhe do duhet të vijojmë me procedimin më tej për trajtimin e këtyre kërkesave, për të cilat nuk është i mundur zbatimi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese janë: Për çështjen penale nr.6, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërsa për çështjen penale nr.5, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1.

Të përjashtohen nga shorti – janë propozimet e tjera të Komisionit – kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zoti Petrit Çomo. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të cilët, në shortin e javës së kaluar u caktuan në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët Bedri Qori dhe Kreshnik Omari. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 5 është gjyqtari Kastriot Gramshi, ndërsa për çështjen nr. 6 janë gjyqtarët Shefkie Mataj Demiraj dhe Kastriot Gramshi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka paraqitur nevojë në një çështje penale. Kërkohen dy gjyqtarë.

Në këtë rast nuk është i mundur zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2. Për një çështje për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së... Atëherë, janë dy gjykata nga duhet të përzgjidhen, do të jetë Dibra dhe Kurbini dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 2.

Përfundimet nga shorti janë, të përfundohen vetëm kryetarët në detyrë të këtyre gjykatave, pra të Dibrës dhe të Kurbinit, zoti Edvan Veçani dhe zoti Ded Miri. Po kështu, të përfundohet nga shorti edhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që ka pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje, zonja Nertila Kape.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord. Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen nr. 1 të Gjykatës së Rrethit Mat, janë gjyqtarët Ardit Kuka dhe Olsi Skrame të përzgjedhur.

Ilir Toska: Okej! Mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka paraqitur nevojë në një çështje që është në lëndë civile. Kërkohej 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm. Do duhet të zbatohet mekanizmi i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 dhe ky të zgjidhet nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në këtë rast përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, zoti Markelian Koça, po kështu të përjashtohen nga shorti dhe gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që janë caktuar më herët në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, që janë Flora Hasimi dhe Besjana Garxenaj.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 1 të Gjykatës së Kavajës, gjyqtari i përzgjedhur është Vladimir Skënderi.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë civile. Kërkohej 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të

veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë 1.

Përgjithësisht nga shorti kemi propozuar vetëm për kryetarin në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zotin Arben Dosti.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Gjyqtarja e përzgjedhur është Blerta Çibuku.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë *(lapsus, pasi bëhet fjalë për Gjykatën Përmes.)*

Atëherë, për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë** janë paraqitur nevoja në 3 çështje. Kërkohe në tre raste 1 gjyqtar.

Ditën e djeshme Këshilli, me vendimin nr. 54, vendosi caktimin në pozicion pranë kësaj gjykate të gjyqtarit Shkëlzen Liçaj. Në këto kushte ka rënë nevoja gjykatës për të tre çështjet, prandaj referuar neneve 90, pika 3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 97/3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni propozon që Këshilli të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pra tre kërkesave konkrete. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me nevojat, për procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec**. Ka paraqitur nevojë në 3 çështje të cilat janë në lëndë penale. Kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë.

Në këtë rast, si dhe në rastet e tjera, mbahet në konsideratë fakti se ditën e djeshme me vendimin nr. 40, datë 29.01.2020, Këshilli ka vendosur caktimin në pozicion të gjyqtarit Artur Prenga.

Nisur nga kjo, për çështjen nr. 2 dhe nr. 3 për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, referuar të njëjtave dispozita ligjore si më herët, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosë deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave nr. 2 dhe nr. 3. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërkohë për çështjen nr. 1, për të cilën kërkohet 2 gjyqtarë dhe praktikisht nevoja mbetet për 1 gjyqtar, do duhet të vijojmë me trajtimin e kësaj kërkesë, duke referuar faktin që është i pamundur zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm. Do duhet të aplikojmë mekanizmin e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni propozon që: Gjykata nga duhet të të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni propozon që të përjashtojë nga shorti kryetaren në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, znj. Luljeta Kole. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që janë caktuar më herët për gjykimin e dy apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, që janë zoti Arben Lera, Markelian Kuqo, Eglantina Mikani, Sonjela Voskopi, Arjola Kristo, Seladin Pysqyli dhe Ervin Sula. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Atëherë, për çështjen nr. 1 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, gjyqtari i përzgjedhur është Besnik Shehu.

Ilir Toska: MbylLEN procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje ka paraqitur nevojë në dy çështje, një në lëndë civile dhe një në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pamundur zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre 2 çështjeve, të jetë 3.

Në opsion të pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese të Komisionit janë: Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të ngarkuar për gjykimin e çështjeve penale për të mitur, -është kërkesa e gjykatës dhe nisur nga pjesëmarrja e të pandehurve në këtë rast.

Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të ndryshëm nga ata sipas pikës 1.

Në këtë rast kemi propozim për përjashtim nga shorti vetëm për kryetarin në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. Durim Hasa. Po kështu, në shortimin e çështjes nr. 1, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që do caktohen për çështjen nr. 2. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit.

Valbona Bako: Atëherë për çështjen nr. 1 gjyqtarja e përzgjedhur është Matilda Llangozi, ndërsa për çështjen nr. 2 janë gjyqtarët Kostika Çobanaqi dhe Lutfije Celami.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka paraqitur nevojë në 2 çështje që janë të dyja në lëndë penale dhe në të dy rastet kërkohet 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast, duke mos qenë i zbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, do zbatojmë mekanizmin e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit, Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast, propozimi për përjashtim nga shorti konsiston vetëm në përjashtimin e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, znj. Ornela Naqellari.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për gjykimin e çështjes nr. 1 dhe nr. 2 gjyqtari i përzgjedhur është Ilir Përdeda.

Ilir Toska: Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë penale dhe kërkohen 2 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit, Komisioni ka këto propozime: Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të

veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Në këtë rast, propozimet për përjashtime nga shorti kemi vetëm për kryetarin në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, zonjën Alma Kolgjoka.

Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Vazhdojmë atëherë me procedurat e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për çështjen nr. 1 janë përzgjedhur gjyqtarët Enkelejda Hoxha dhe Engjellushe Tahiri.

Ilir Toska: Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur nevojë në një çështje, që është në lëndë penale. Kërkesa është paraqitur përpara se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 55 të ditës së djeshme, pra datës 29 janar, ka caktuar pranë kësaj gjykate në pozicion gjyqtarin Florin Demollari. Për rrjedhojë, referuar neneve 90/3, 95 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe nenit 97, pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni propozon Këshillit që të vendosë deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kësaj kërkesë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Sa i përket kërkesave të **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë**, ka paraqitur nevojë në 4 çështje. Edhe në këtë rast kërkesat janë paraqitur përpara se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 49, datë 29.01.2020 dhe nr. 51, datë 29.01.2020 ka caktuar në pozicion pranë kësaj gjykate gjyqtarët Enisa Shahini dhe Ligoraq Toshi. Në këto kushte, bazuar po në të njëjtat dispozita të Kodit të Procedurave Administrative pra 90/3 dhe 95, si dhe të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” neni 97/3, Komisioni i propozon Këshillit të vendosë deklarinimin e përfunduar, pa një vendim

përfundimtar, të shqyrtimit të 4 kërkesave konkrete të paraqitura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dhe e fundit është **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë**, e cila ka paraqitur nevojë në 6 çështje, përpara se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 52 dhe 53 datë 29 janar ka caktuar në pozicion pranë kësaj gjykate gjyqtarët Hazbi Balliu dhe Ema Shaholli, për rrjedhojë, referuar neneve 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 97/3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni propozon Këshillit të vendosë deklarin të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të 6 kërkesave konkrete të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Faleminderit!

Me kaq mbyllen procedurat e shortit

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse s’keni ndonjë çështje tjetër, mbledhja konsiderohet e mbyllur.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor